

**AKT- THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"NAGUIB CONSTRUCTION" SH.P.K.**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "NAGUIB CONSTRUCTION" Sh.p.k.

- 1- **HUSSEIN AHMED NAGIB GOUDA** atesia **AHMED**, shtetas EGJIPTJAN, lindur me 16/03/1986 ne MENIA, identifikohet nepermjet pasaportes A27377746.
- 2- **NAGUIB AHMED NAGUIB GOUDA** atesia **AHMED**, shtetas EGJIPTJAN lindur me 17/02/1990 ne MENIA, identifikohet nepermjet pasaportes A25166342.

Në përputhje me vullnetin e tyre te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendoset të hartojnë këtë akt themelimi të shoqërisë "NAGUIB CONSTRUCTION" Sh.p.k. mbi bazen e ketyre principeve:

**NENI 1  
FORMA DHE EMRI**

Shoqëria ka formen e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me initiale SH.P.K., dhe i perballon humbjet deri ne kufirin maksimal te vleres se kontributit te ortakeve ne kapitalin themeltar. Emri i shoqerise "NAGUIB CONSTRUCTION" Sh.p.k.,

**NENI 2  
BAZA LIGJORE**

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marreveshjet nderkombetare te ratifikuara dhe qe do te ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.


**NENI 3  
SELIA**

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga "DESHMORET" Lagja nr. 4, Godina me xhama ,afër karburant ALPET ,kati i 2 ,Zyra 22, Nr. Pronesie 6/62, zona kadastrale 8514, Durres, Shqiperi.

Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik.

AKT THEMELIMI "NAGUIB CONSTRUCTION"



Aplikanti  
Jonas Waga 

Me vendim te asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose perfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë sipas fushave ne te cilat e ushtron veprimtarine shoqëria.

#### NENI 4

#### KOHEZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit ne organin kompetent. Shoqëria prishet dhe kalon në procedure likuidimi, sipas rasteve te parashikuara me ligj.

#### NENI 5

#### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria "NAGUIB CONSTRUCTION Sh.p.k. është e organizuar në formën e një shoqërie e cila ka si objektiv punime në fushën e ndërtimit.

#### NENI 6

#### KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 LEKE (Njeqind mije Leke), i ndarë në 2 pjesë .Kapitali themeltar i shoqërisë zoterohet nga:

1. HUSSEIN AHMED NAGIB GOUDA	50,00%	50.000,00 LEKE
2. NAGUIB AHMED NAGUIB GOUDA	50,00%	50.000,00 LEKE

Kapitali themeltar i shoqërisë është shlyer tërësisht dhe depozituar ne nje llogari të hapur në emër të shoqërisë në një nga bankat e nivelit të dyte.

#### NENI 7

#### AKTET E SHOQERISE

Shoqëria do te rregullohet, perveç këtij akt-themelimi edhe me norma te percaktuara ne statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërisë dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërisë.

#### NENI 8

#### ORGANET DREJTUESE


Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve dhe Administratori. Shoqëria mund të emëroj më shume se një administrator. Në çdo rast, kur termi "Administrator" përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërisë "NAGUIB CONSTRUCTION" Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë

AKT THEMELIMI "NAGUIB CONSTRUCTION"





Aplikanti



administratorët e saj sado qofshin këta në numer. Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre. Administratorët e shoqërisë për një periudhë 5 (pese) vjeçare janë emeruar:

1. HUSSEIN AHMED NAGIB GOUDA
2. NAGUIB AHMED NAGUIB GOUDA
3. JONA LUGA

Te cilet mund te ushtrojne kompetencat e tyre se bashku ,ose edhe vec e vec .

### NENI 9 DISPOZITAT E FUNDIT


Çdo mosmarrveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zhgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarrveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tiranë.

Ky akt themelim është hartuar në 3 (tre) ekzemplarë në gjuhën shqipe, duke patur secili ekzemplarë fuqi të njëjtë ligjore.


Tirane 29/03/2021

### ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE "NAGUIB CONSTRUCTION" SH.P.K.

HUSSEIN AHMED NAGIB GOUDA



NAGUIB AHMED NAGUIB GOUDA



AKT THEMELIMI "NAGUIB CONSTRUCTION"

Aplikanti

Jona Luga

